



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës
Mbledhja nr. 4
Prishtinë, me 21 korrik 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

**nga mbledhja e Komisionit për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Kolë Berisha, Hydajet Hyseni, Xhezair Murati, Fehmi Mujota, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Besa Gaxherri, dhe Ismet Beqiri.

Munguan: Fehmi Mujota, Suzan Novoberdaliu, Radmilla Vujović.
Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit mori pjesë: Eshref Vishi
Nga Departamenti ligjor mori pjesë: Daut Beqiri, Drejtor i Departamentit

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi:
Ahmet Isufi, Kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 08.07.2008**
- 3. Shqyrtimi i Rregullores së re të punës së Kuvndit**
- 4. Rekomandim lidhur me kërkesen për heqjen e imunitetet të deputet z.Sabit Rrahmani**
- 5. Të ndryshme**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 08.07.2008

Procesverbali nga mbledhja e datës 08.07.2008, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Rregullores së re të punës së Kuvndit

Në lidhje me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes kërkoi, që secili nga anëtarët e komisionit të sjellin materialin e nevojshëm për hartimin e Rregullores së Punës së Kuvndit, në mënyrë që ky material të paraqitet në formë tabelore, ta kem të gatshme për punimet e mëtutjeshme të rregullores që do të mbajmë në Ohër. Ai gjithashtu kërkoi nga anëtarët që ta konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në këtë punëtori.

Besa Gaxheri tha, unë kur të vijmë te shqyrtimi i komisioneve kërkoi që në komisionin për buxhet, së paku nënkryetari i këtij komisioni të jetë nga opozita.

Dezair Murati tha, unë kësaj radhe nuk kam mundur të jap më të mirën që unë mund ta bëjë dhe gjithashtu këtë material nuk e kam marr në gjuhën time prandaj e kam pas të vështirë të punoj aq sa duhet, por besoi se në punëtorin në Ohër do ta kem këtë draft edhe në gjuhën time dhe unë do të mund të jap kontributin tim më shumë.

Hydajet Hyseni, propozoi që si bazë për punën në të ardhmen ta kemi Rregulloren aktuale e cila është në tri gjuhët, sepse është e vështirë të përkthehet çdo material të cilin ne e punojmë, meqenëse do të përkthehet simulant atëherë do ta kemi edhe më të lehtë punën.

4. Rekomandim lidhur me kërkesën për heqjen e imunitetit të deputet z.Sabit Rrahmani

Kryesuesi i njoftoi anëtarët për shkresën që ka ardhur nga gjykata në lidhje me kërkesën për heqjen e imunitetit të deputetit z.Sabit Rrahmani, ai gjithashtu i njoftoi se deputeti në fjalë e ka telefonuar dhe ka kërkuar që komisioni ta shtyjë këtë çështje deri në muajin gusht sepse ai ndodhet në shërim jashtë vendit dhe se deri në këtë kohë do të kthehet për tu deklaruar vetë.

Besa Gaxheri tha, përkundër asaj që ne e kemi koleg, ne të gjithë këtu i dimë ankesat e tij dhe mendoj se ne duhet ta marrim një vendim që ta lirojmë gjykatën të merret me punën e saj, prandaj kundërshtoj shtyrjen që ne ta marrim një vendim të tillë sepse nëse ne nuk jemi në gjendje të marrim një vendim të tillë atëherë ne po e shkelim Kushtetutën.

Hydajet Hyseni, jam për ruajtjen e imazhit të deputetit dhe besoi që nuk duhet të ngutemi edhe pse ne të gjithë këtu jemi të njohur rreth çështjes së tij, mirëpo OSBE-ja ja

ka mundësua vazhdimin e mandatit edhe përkundër asaj se kanë qenë të njohur me çështjen e tij, prandaj këtu duhet të dihet se me çfarë arsyes OSBE-ja e ka marr këtë vendim. Unë mendoj se ne mund t'ia kthejmë gjykatës një përgjigje me një deklaram me shkrim se në muajin gusht deputeti do të kthehet dhe do ti dorëzohet vet gjykatës.

Kolë Berisha, kërkoj që ti merret imuniteti deputetit Sabit Rrahmani, sepse kjo është një çështje që po përsëritet vazhdimisht dhe mendoj se duhet ta lejojmë gjykatën të kryej punën e saj.

Dezair Murati tha, edhe unë mendoj se duhet ti ruhet imazhi i deputetit sepse edhe ashtu ne ende nuk e kemi ndonjë imunitet. Mirëpo te rasti i z.Rrahmani deklarata e tij se do të kthehet në muajin gusht sipas mendimit tim është një deklaratë blanko sepse askush s'mund ta garantoj kthimin e tij.

Ismet Beqiri tha, pa dashur të ndalem shumë në personalitetin e deputetit për veprimet e të cilit të gjithë jemi të njohur, meqenëse kjo çështje edhe ashtu nuk do të mund të procedohet në seancë deri në muajin shtator për shkak të pushimeve, atëherë mendoj se ne duhet ta kemi një vendim të përbashkët dhe në çoftë se deputeti nuk kthehet deri në kohën për të cilën ka thënë, atëherë vendimin e përbashkët, që në takimin ton të ardhshëm të vendosim për procedim të mëtutjeshëm.

Komisioni ka nxjerr këtë përfundim:

z.Sabit Rrahmani deri në muajin shtator të paraqitet dhe të deklarohe para komisionit dhe më pas komisioni do ta merr një vendim i cili do të procedohet menjëherë për seancë.

3. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 12.40

Ahmet Isufi
Kryetar i Komisionit

Përgatiti:
Njësia mbështetëse e komisionit